

Nr: 70/2023	Nr: Protokolli: 103/2023
Për:	Operatorin Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K., Pirane, PIRANE
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	21.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket Kërkesës për Rishqyrtim, të parashtruar me datë: 18.09.2023 nga Operatori Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K., Pirane, PIRANE** me adresë në Piranë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje** me Numër të prokurimit: **624-23-6986-1-1-1** Numër i brendshëm: **624-23-50-111** nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar **Kërkesa për Rishqyrtim** e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K., Pirane, PIRANE** me adresë në Piranë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje** me Numër të prokurimit: **624-23-6986-1-1-1** Numër i brendshëm: **624-23-50-111** kundër: **(NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK)**, të datës: **13.09.2023** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Me gjithatë Autoriteti Kontraktues, qëndron pran njoftimit mbi vendim (B58) të publikuar me datë 13.09.2023 ngase, rezultati nuk ndryshon
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Suharekës me datë 18.09.2023 ka pranuar kërkesë për rishqyrtim nga OE **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P."GRESA - COMMERCE "; MBB Construction SH.P.K., Pirane, PIRANE** me adresë në Piranë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me dru dhe pelet per ngrohje** me Numër të prokurimit: **624-23-6986-1-1-1** Numër i brendshëm: **624-23-50-111**

kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN,E AK)** , të datës: **13.09.2023** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **18.09.2023** sipas **nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092**

- Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 citoj:

"Ne kemi prezantuar referenca për kontratat të cilat janë përfunduar 100%, e disa të tjera 128% dhe 130%, mirëpo autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh fare duke u arsyetuar se kinse nuk janë të përfunduara këto kontrata.

Në lidhje me referencën-Shkolla fillore e Mesme e Ulët "8 Dëshmorët" në Kralan, ju sqarojmë se e njëjta referencë është dashur të merret parasysh për faktin se kontrata për të cilën është lëshuar kjo referencë është e përfunduar 100% dhe njëkohësisht është shfrytëzuar edhe devijimi i lejuar prej 30%, pra kontrata është përfunduar në tërësi. Autoriteti kontraktues është bazuar vetëm tek kohëzgjatja e kontratës, mirëpo në këtë rast kjo kontratë është kontratë kornizë dhe e njëjta përfundon në momentin që përfundohet furnizimi. Përderisa është bërë furnizimi i lartcekur 100% dhe njëkohësisht është shfrytëzuar edhe 30% i devijimit të lejuar, atëherë kjo kontratë është e përfunduar, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt"

- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.1

Bazuar në nenin " 54.10 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik i cili ndër të tjera përcakton si në vijim : Nëse AK deklaron përqindjen e mospërfutjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht...."

AK e merrë si të bazuar pretendimin ankimor me Nr 1 dhe njëkohësisht e pranon si të mirëqene referencën Në lidhje me Kontratën “Shkolla fillore e Mesme e Ulët “8 Dëshmorët” në Kralan” vlera e së cilës është 253,162.00 €uro.

- **Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 citoj:**

“Sa i përket referencës tjetër të cilën AK-ja nuk e ka marr parasysh-Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore-Komuna Klinë, ju sqarojmë se edhe në këtë rast kontrata për të cilën është lëshuar kjo referencë është e përfunduar 128%, pra përveç se është kryer furnizimi i 100% të kontratës AK-ja KK Klinë ka shfrytëzuar edhe 28% e devijimit të lejuar. Përveç këtij fakti AK-KK Klinë ka publikuar aktivitetin e prokurimit të njëjtë sikurse aktiviteti për të cilin ne i kemi bërë furnizimet dhe njëkohësisht ka nënshkruar edhe kontratën për të njëjtin aktivitet, pra është nënshkruar një kontratë e re.

- *Përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim po ju bashkangjesim edhe sqarimin e KK Klinë, ku të njëjtit e konfirmojnë faktin se e kanë kaluar kontratën me 128% dhe se të njëjtit kanë lidhurnjë kontratë të re.*
- *Andaj nga ky fakt kuptohet se edhe kjo kontratë ka përfunduar për faktin se tanimë KK Klinë ka lidhur kontratë një kontratë të re me një OE tjetër dhe kjo kontratë është e përfunduar, andaj edhe referenca është dashur të merret parasysh. (Bashkangjitur gjeni sqarimin dhe konfirmimin nga KK Klinë dhe kontratën e nënshkruar)”.*

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.2**

Gjithashtu Bazuar në nenin “ 54.10 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik i cili ndër të tjera përcakton si në vijim : Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht....”

AK e merë si të bazuar pretendimin ankimor me Nr 2 dhe njëkohësisht e pranon si të mirëqene referencën Në lidhje me Kontratën “Furnizim me pelet për ngrohje të objekteve shkollore-Komuna Klinë,” vlera e së cilës është 130.891.49 €uro

- **Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.3 citoj:**

"Në lidhje me referencat nga Universiteti Haxhi Zeka, të cilat referenca autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh, ju sqarojmë se edhe këto kontrata janë përfunduar 100%. Vlen të ceket fakti se edhe Universiteti Haxhi Zeka ka publikuar njoftimin për kontratë me titull "FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë-KONTRATË

KORNIZË", ku përveç njoftimit për kontratë e njëjta ka publikuar edhe njoftimin mbi vendimin me dt.01.09.2023, ku vet ne si OE jemi rekomanduar për kontratë dhe tani jemi në pritjes të nënshkrimit të kontratës. (Bashkangjitur gjeni njoftimin mbi vendimin dhenjoftimin për kontratë).

Duhet cekur fakti se tek kontratat kornizë ku parashihen sasisë e përafërta dhe +-30%, kontrata mund të përfundohet me realizimin e furnizimeve prej 70% deri në 130%, varësishtprej kërkesave dhe nevojave të AK-së. 30% është tavani i përcaktuar për realizimin e mundshëm të furnizimeve, ndërsa nuk është obligative që të realizohet 130% kontrata, pormund të realizohet edhe 100, 105, 110 etj".

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.3**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.3, sipas AK nuk qëndron. Referenca e lëshuar për kontratën "**FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë-KONTRATË**" përcakton qartë se kontrata do të përfundon me datë **29.09.2023** dhe nuk përcakton se sa % e vlerës së kontratës apo sasisë indikativë është realizuar. Ndërsa sa i përket inicimit të këtij aktivitet të Prokurimit nga AK (e përmendur në kërkesën tuaj për Ri-shqyrtim) ju sqarojmë se asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalon inicimin e aktivitetit pa u përfunduar Kontrata, me rendësi është që nënshkrimi i Kontratës së re të mos ndodh para datës së përfundimit të kontratës aktuale.

- **Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.4 citoj:**

"Gjithashtu së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim po ju bashkangjesim edhe transaksionet bankare në lidhje me kontratën me kompani private e cila është përfunduar në tërësi, ashtu siç vërtetohet edhe nga transaksionet të cilat po ju bashkangjesim".

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.4**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.4, sipas AK gjithashtu nuk qëndron. Referenca e lëshuar për kontratën me kompani private transaksionet bankare në lidhje me kontratën të ofruara si dëshmi me ofertën e juaj nuk korospondojn njëra me tjetrën. Referenca e lëshuar nga N.T.P. HAXHA është lëshuar me vlerë **213.958.00 Euro** ndërsa në transaksionet bankare në lidhje me kontratën të ofruara si dëshmi me ofertën e juaj ekziston vetëm një transaksion në emër të Haxhi Zejnullahu BI pagesa e faturës me datë 03.04.2023 në vlerë prej 2.400 euro ndërsa transaksioni bankar i ofruar me Kërkesë për ri-shqyrtim pasqyron vetëm transaksionet bankare në vlerë prej **205.676.00 Euro** të viteve 2019, 2020 dhe 2021 pa pasur përshkrim të transaksioneve dhe nuk dihet se në mes të kujt janë bërë këto transaksione.

Gjithashtu referenca e ofruar për kontratën me titull “Furnizim me Dru zjarri” në komunën e Prizrenit në vlerë **30.940.00 €** është e papranueshme pasi që e njëjta ka përfunduar me datë **26.05.2020**, ndërsa Aktiviteti i prokurimit “Furnizim me dru dhe Pelet” i Komunës së Suharekës është publikuar me datë **11.07.2023**.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura edhe pse dy pretendimet ankimore janë pruar si të bazuara referencat për Kontratat me tituj “**Shkolla fillore e Mesme e Ulët “8 Dëshmorët” në Kralan**”, “**FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë-KONTRATË KORNIZË**” Autoriteti Kontraktues qëndron pran njoftimit mbi vendim (B58) të publikuar me datë 13.09.2023 ngase:

Autoriteti kontraktues për kërkesën e parashtruar në DT sa i përket realizimit të kontratave ka kërkuar dëshmi (referenca) në vlerë **1.400.000.00** ndërsa ju si Operator Ekonomik (edhe pas pranimit të dy referencave të lartë përmendura) nuk keni ofruar referenca në vlerën e kërkuar nga AK. Vlera e referencave të ofruar nga ju si OE është **1,180,866.86 €** kështu që AK do të qëndron pran njoftimit mbi vendim (B58) të publikuar me datë **13.09.2023** ngase, **rezultati nuk ndryshon edhe pas pranimit të dy referencave të lartë përmendura.**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 duke marrë për bazë të gjitha dispozitat ligjore.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

Komuna e Suharekës

